



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 24, paragrafi 5 dhe nenit 25, paragrafi 6 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, mori këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI
ELEKTRIKE (KEDS)

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë të rregullt konkurrimi.

- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 3538-3, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-03538-3, Zona kadastrale Prishtinë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5043 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 27m², nga pjesët e parcelave kadastrale nr. 07336-0 dhe nr. 07339-0 Certifikatat e pronësisë nr. P-71914059-07336-0, P-71914059-07339-0, nga sipërfaqet e përgjithëshme 2039 m² dhe 2330 m², jepen në shfrytëzim sipërfaqja prej 27 m², Zona kadastrale, Prishtinë, pjesë e parcelës kadastrale nr. 00161-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-00161-1, Zona kadastrale, Prishtinë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1808 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 34m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 01926-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01926-0, Zona kadastrale Prishtinë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5137 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 01131-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-1131-0, Zona kadastrale Prishtinë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1549 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 27m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 00112-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00112-0, Zona kadastrale, Matiçan, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1578 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 27m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 1018-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01018-0, Zona kadastrale Matiçan, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 21584 m² jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 28m².

- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekura në pikën II të këtij propozimi, është vendosja e trafostacionit të ri 10(20)kV me fuqi 250 kVA, vendosja e trafostacionit të ri, me fuqi 160kVA, vendosja e trafostacionit të ri 10 (20)kV, me fuqi 400 kVA, vendosja e trafostacionit të ri 10(20)kV, me fuqi 160 kVA, zhvendosja e trafostacionit ekzistues 10 (20) kV, zhvendosja e trafostacionit ekzistues, vendosja e shtëpizës së re në lokacionin e njëjtë me parcelën nr. 07339-0 dhe parcelën nr. 07336-0, ZK, Prishtinë.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është për 15 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.
- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi jepet në shfrytëzim me kompensim.
- Llogaritja e kompensimit për sipërfaqe në m² bëhet për tokën e dhënë në shfrytëzim. Sipërfaqja për m² është 3.5 € andaj për sipërfaqen totale prej 179 m², pagesa është 626.5 € në vit.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- skica grafike,
 - kopja e planit dhe certifikata e pronës.
- X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/02-112357/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

